



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.909/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitia Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesve-kreditorët; 1.N.N “E...” me numër të biznesit me seli në Skenderaj përfaqësuar drejtori menaxhues I.H, dhe 2. N.P.SH “F...” me numër biznesi Komuna e Skenderajit përfaqësuar nga drejtori menaxhues B.I, e të cilët përfaqësohen sipas autorizimit nga B.K avokat nga Prishtina, kundër propozuesi – debitorit “L...” Sh.p.k me numer biznesi, numër fiskal, me seli në Skenderaj, përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues M.H, e të cilin e përfaqëson me autorizim B.T avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesve të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EF.nr.4/21 datës 21.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 30.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundër propozuesve-kreditorëve; 1.N.N “E...” me numër të biznesit me seli në Skenderaj përfaqësuar drejtori menaxhues I.H, 2. N.P.SH “F...” me numër biznesi Komuna e Skenderajit përfaqësuar nga drejtori menaxhues B.I, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EF.nr.4/21 e datës 21.01.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar V.EF.nr.4/21 datës 21.01.2022, ka vendosur si në vijim;

“REFUZOHET si e pa bazuar propozimi për falimintim i parashtruar nga kreditorët N.N “E...”, me numër të biznesit me seli në Skenderaj, dhe N.P.SH “F...”, me numër biznesi me seli në KK Skenderaj, me të cilin kanë kërkuar që debitori “L...” shpk me numër të biznesit, me seli Komuna e Skenderajit të shpallët si i falimentuar dhe biznesi të shuhet nga regjistri pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë propozuesit-kreditorët përmesë të autorizuarit të tyre, për shkak të shkeljes së ligjit material dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjës faktive, me propozim që Gjykata Komerciale e Shkallës së Dytë të aprovohet ankesa e kreditorëve si e bazuar, ashtu që aktvendimi V.EF.nr.4/21 i datës; 21.02.2022, ta anulon dhe çështjen ta kthejë në vendosje dhe rigjykim.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë edhe pse i njejt i ka pranuar ankesën e kreditorëve me datën 22.02.2022.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesit 1.N.N “E...” me numër të biznesit me seli në Skenderaj, dhe 2. N.P.SH “F...” me numër biznesi me adresë Komuna e Skenderajit, kanë paraqiturë kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, si pasojë e mos pagimit të borxheve ndaj kreditorëve, ku dhe kanë kërkuar që debitori “L...” Sh.p.k. me seli në Skenderaj, ti ndalohen të gjitha veprimet, përfshirë shitjen, bartjen apo qiradhënien e pasurisë së debitorit; ndërpriten të gjitha kërkesat dhe procedurat që kanë për qëllim përmbushjen e kërkesave-borxheve ndaj debitorit, si dhe të njoftohen për procedurën e likuidimit Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, Zyra e Pengut, Bankat dhe Administrata Tatimore në Kosovë; të shpallet falimentimi i debitorit, ashtu që pas përfundimit të procedurës së falimentimit të shuhet biznesi nga rregjistri pranë Agjencisë Për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, si dhe të ndërmerren të gjitha veprimet tjera në pajtim me Ligjin e Falimentimit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se nga kërkesa-raporti i administratorit të falimentimit të datës 19.11.2021, ka gjetur se debitori është në situatë të pa aftësisë paguese. I njejt posedon asete në vlerë prej 20.500.00 euro, kurse borxhet ndaj kreditorëve janë konstatuar në lartësinë prej 876,322.10euro. Ndër të tjera ka shtuar se nuk ja fali besimin raportit të administratorit ku ka konstatuar se debitori ka aftësi likuide për përmbushje të detyrimeve ndaj kreditorëve për shkak se gjykata ka gjet se administratori si llogari të arkëtushme i kishte përfshirë edhe kërkesat e këtu debitorit ndaj debitorëve të tij (jashtë kësaj procedurë të falimentimit), përkundër faktit se këto kërkesa janë në procedura gjyqësore, dhe se të njejtat përmbajnë rrezikshmëri (në kuptim të realizimit të tyre), për shkak se procedurat gjyqësore të cilat janë duke u zhvilluar mbi bazën e këtyre kërkesave, janë të paparashikueshme si në aspektin kohor ashtu edhe në aspektin e mënyrës së vendosjes, ndërsa në rast të mos realizimit të kërkesave në procedurë gjyqësor, administratori kishte theksuar se debitori nuk mund të ketë aftësi likuide. Duke qenë të tilla pra të paparshikueshme gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se këto kërkesa nuk mund të llogariten si pjesë përbërse e pasurisë së falimentimit në rastin konkret ngase për ta konsideruar një kërkesë si pjesë përbërse e llogarive të arkëtushme, duhet të ekzistoj një afat kohor i caktuar, brenda të cilit kërkesa e tillë do të realizohet sigurt, konkretisht nuk duhet të ketë mëdyshje lidhur me realizimin e kërkesës në një afat kohor të caktuar/njohur, ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se edhe po të ishte ndryshe pra edhe po që se kërkesat e debitorit në procedura gjyqësore hyjnë në kuadër të llogarive të arkëtushme përsëri nuk kemi të bëjmë me aftësi likuide të debitorit në këtë çështje falimentimi, kjo pasi që nëse shuma e aseteve dhe kërkesave të debitorit është në lartësi prej 926,640.30 euro, ndërsa shuma e borxheve të debitorit është në lartësi prej 941,322.10 euro (shtuar borxhin e gjetur me vonë në shumë prej 65,000.00euro), atëher bilanci i aktivës së debitorit del të jetë më i vogël se sa bilanci i pasivës, dhe krejt në fund ka vendosur se kërkesa për falimentim është e pa bazuar për faktin se debitori nuk ka të dhëna në lidhje me ecurin e kapitalit themeltar pasi që nga të dhënat e ARBK-së nuk ka të paguar kapitalin themeltar edhe pse ka qenë i detyruar në kuptim të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, kështu në bazë të

nenit 21 dhe 19 të Ligjit Për Falimentimit, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjyakata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë, kur ka vendosur që ta refuzoj kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit për arsye se nuk ekziston paaftësia paguese e debitorit, dhe se debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas Ligjit për falimentim. Kështu edhe dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore me nenin 19 për hapjen e rastit të falimentimit.

Dhomës së Shkallës së Dytë, ka analizuar pretendimet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës material këto pretendime nuk gjejnë mbështetje ligjore, për shkak se në bazë të dhënave dhe provave që janë në shkresa të lëndës konstaton se në rastin konkret është më e preferushme lejimi i veprimtarisë të debitorit në mënyrë që ai të ketë mundësi të krijoj mjetet dhe të realizoj kërkesat e tija ndaj debitorëve të tjerë, ashtu që krijohen mjetet për shpenzimet e procedurës së falimentimit si edhe mjetet për kthimin e borxheve ndaj kreditorëve e posaqërisht ndaj ATK-së. Përndryshe me mjetet ekzistuese që posedon debitori nuk mund ti realizohen kërkesat e kreditorëve e as shpenzimet e procedurës së falimentimit, e mos të flasim për kërkesat e ATK-së i cili nuk është kërkuar në këtë kërkesë për falimentim.

Ndërsa, sa i përket dispozitës së nenit 22 pika 4 ku thuhet se “*Gjykata e njofton menjëherë regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengut, bankat komerciale, regjistrin e kredive të Bankës Qendrore dhe administratës tatimore për inicimin e procedurës së falimentimit*”, Gjykata e Shkallës së Dytë konstaton se pjesërisht është përmbush kjo dispozitë, por sa i përket njoftimit të instituconeve tjera nuk është relevante meqenëse gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit e që e mbështet edhe kjo gjykatë me arsyetimin e cekur më lartë, andaj në mungesë të mjeteve për procedurë të falimentimit dhe në mungesë të aseteve me vlerën e borxhit të kërkuar, e edhe duke pas në konsiderat procedurat të cilat janë në zhvillim e sipër për realizimin e borxheve që i ka debitori në institucionet e cekura në raportin e administratorit.

Kjo gjykatë preferon që poqëse në ndërkohë zbulohen mjetet financiare tek ndonjë bankë apo asete të cilat deri tani nuk janë paraqit kreditorët mund të shfrytëzojnë procedurat sipas ligjit përmbarimor.

Kjo ngase sipas certifikatës të rregjistrimit të biznesit debitori ka të rregjistruar një mori veprimtarish, dhe po që se falementohet atëherë gjasat për realizimin e kërkesave të kreditorëve janë minimale apo ma mir me thanë të pamundshme sepse ekziston mundësia që të rregjistrohet një biznes tjetër dhe hap llogarit e tjera rrjedhëse dhe i realizon kërkesat që i ka në procedurë, e kreditorët mbesin pothuajse pa e realizuar kërkesat e veta, kështu kemi cekur edhe më sipër se është më e preferushme që debitorit ti lejohet zhvillimi i procedurave për realizimin e kërkesave të tija të cilat janë në procedurë e sipër si përshembull ajo me Komunën e Leposaviqit e tjera.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të kreditorëve lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dhe se arsyetimi i vendimit përmban arsye të mjaftueshme ligjore për të vendosur në këtë qështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon Dhoma e Shkallës së Dytë.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 21 paragrafi 1.2 neni 19 pika 2, të Ligjit Për Falimentim, dhe 195.1 nën pikën d) e lidhur me nenin 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, si dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komeriale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.909/22 datë 01.09.2022

Kryetarja e Kolegjit-Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri